

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **I.K. I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **711-25-1702-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me AC**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	AS Tech SH.P.K.
NUI	601262611
Adresa	AHMET KRASNIQI
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	-
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	AFRIM SADIKU
Adresa elektronike	shpk.astech@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	09.06.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me AC

Ankese kunde rVendimit të AK-se për shperblim të OE Infinit sipas vleresimit tone i papergjegjshem dhe kunder Vendimit të shqyrtimit të Kerkeses për rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Ne sistem

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6 LPP

Neni 7 LPP

Neni 59 LPP

Neni 60 LPP

Udhëzuesi 02/2024- 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve ista e çmimeve nuk është plotësuar Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Kusht administrativ

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Paraqesim këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues për shpërblimin e ofertës së OE “Infinit” me kontratë, për procedurën: **Furnizim me AC - 711-25-1702-1-2-1.**

Vlerësojmë se AK ka bërë shkelje të LPP-së dhe kritereve të dosjes së tenderit gjatë vlerësimit të kësaj procedure, si rrjedhojë pretendimet tona do t’i paraqesim më poshtë:

Pretendimi 1 – Tekalimi i afatit të liferimit

Në Aneksin 1 të Dosjes së tenderit është kërkuar: *Afati i liferimit maksimumi 2 muaj – një deklaratë (e nënshkruar dhe vulosur), origjinali i skanuar në ofertë nga ofertuesi.* E njëjta kërkesë është kërkuar edhe te Përshkrimi i Çmimit – *Koha e dërgesës maksimum.*

OE “Infinit” ka dhënë deklaratë të ndryshme. Në një deklaratë ka dhënë afat 2 muaj për liferimin e produkteve, ndërsa te përshkrimi i çmimit ka dhënë deklaratë për 3 muaj. Përveç që ka dhënë deklaratë të ndryshme brenda të njëjtës ofertë, OE “Infinit”, sipas **UDHËZUESIT NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK**, duhet të eliminohet automatikisht sepse nuk e ka plotësuar si duhet Përshkrimin e Çmimeve:

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve
10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur, AK duhet të veprojë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së
Lista e çmimeve nuk është plotësuar – Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm – Kusht administrativ.

OE pikërisht te Përshkrimi i Çmimeve ka dhënë afat liferimi një muaj më shumë sesa që AK ka kërkuar, që do të thotë se ai ka deklaruar se nuk mund t’i përmbahet kërkesës së

dosjes dhe AK-së që liferimi të bëhet në kohë. Mos përmbushja e këtij kriteri e bën ofertën automatikisht të papërgjegjshme. Arsyeimi i AK-së se e kemi vlerësuar si “gabim të vogël” nuk qëndron, sepse është kusht i dosjes që afati i liferimit të jetë 2 muaj dhe jo 3. Për më tepër, mosplotësimi si duhet i Përshkrimit të Çmimit është kusht administrativ sipas udhëzuesit.

Po ashtu, nëse ky kriter do të ishte prej fillimit 3 muaj në dosje, do të kishin mundur të ofertojnë shumë e shumë OE të tjerë, por ndoshta për shkak të afatit të shkurtër prej 2 muajsh nuk kanë ofertuar.

Prandaj, favorizimi i një OE-je që jep afat liferimi në mospërputhje me kërkesën, është jashtë çdo praktike të prokurimit transparent publik.

Pretendimi 2 – Mungesa e dokumentit të kërkuar për cilësinë e produktit

*OE i rekomanduar nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes të **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – pika 2:** Operatorët ekonomikë duhet të ofrojnë*

*dëshmi të mjaftueshme se produktet që do të furnizohen janë të kualitetit brenda standardeve të BE-së, dhe dëshminë – **Evidenca 2:** Çertifikatë mbi kualitetin ose deklaratë e konformitetit.*

OE “Infinit” ka dorëzuar në ofertë vetëm një çertifikatë ISO 9001:2015, e cila ka të bëjë me menaxhimin e cilësisë së kompanisë, e jo të produktit, siç është kërkuar në Dosje.

Kjo nuk e përmbush kriterin teknik të kërkuar dhe, për rrjedhojë, oferta e tyre duhet të konsiderohej e papërgjegjshme.

*AK në këtë rast ka bërë shkelje të **nenit 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve:***

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara

në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

AK, madje as pas kërkesës tonë për rishqyrtim, nuk ka reflektuar që lënda të kthehet në rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet konform kërkesave të dosjes së tenderit. AK, në vendimin

për kërkesën për rishqyrtim, ka deklaruar se OE Infinit ka çertifikatën e konformitetit për brendin që ka ofruar, por kjo nuk na ka dhënë bindje, pasi nuk është sjellë Letër standarde

për sqarim të dosjes që i është dërguar OE “Infinit por as përgjigja që ka sjellë OE, sepse në FDT një dokument i tillë nuk ekziston.

AK e ka bërë qasjen e dokumenteve përmes e-Prokurimit, dhe janë prezantuar dokumente për të cilat nuk dihet as kujt i përkasin me titull te Follderit:

“**Katallogu, Specifikimet teknike**”, jashtë atyre që janë pjesë e ofertës së secilit OE pjesëmarrës.

Nëse AK e ka pasur fjalën që ka ngarkuar dokumentet që kemi kërkuar, atëherë ndalemi më shumë në analizën e dokumenteve të ngarkuara në e-Prokurim,

edhe pse nuk dihet se pjesë e cilës oferte janë. Atëherë gjykojmë se janë dëshmi të katalogut të brendit Chigo, që vlerësojmë se mund të jenë të OE Infiniit sepse në Përshkrim të çmimit e ka të cekur këtë brend.

Tërë ato dokumente në këtë folder janë shumë të paqarta dhe kundërthënëse me njëra-tjetrën:

? Ne folder është ngarkuar “Katalogu Chigo” I cili përmban specifikat e klímave që nëse I krahasojmë specifikat e klímave 9000 BTU me ato të 12000 BTU janë

pothuajse identike përfshirë edhe peshën e tyre, që është shumë e pakuptimtë duke e ditur madhësinë që dallon shumë mes tyre dhe nuk ka mundësi teknike as

logjistike të këne peshe të njëjta,

? Katalogu shkruan Chigo, ndërsa tek modeli I cekur tek specifikimet teknike ZKFP-20-8-98-2 për 12000 BTU dhe ZKFP-50-8-9-1 për 18000BTU si dhe modelet e kompresorëve **KSN98D32UEZ për 12000 BTU dhe KSN140D42UFZ për 18000 BTU** gjatë shfletimit të internetit askund nuk japin dëshmi se janë të prodhuesit Chigo, por të prodhuesve të tjerë, siç i shihni në **Prova 1**.

? Tek dokumenti në këtë folder me emrin “Klasa e energjisë” brenda saj është i dokumentuar modeli **CSDH-12DA** që sipas hulumtimeve në internet është një klimë mini-split e markës Changhong Ruba, prodhuar nga Changhong Electric, dmth jo e markës Chigo siç OE Infiniit ka ofertuar në Përshkrim të çmimeve dhe tek Katalogu I bahskangjitur në këtë folder. Madje specifikat e këtij brendi janë ndryshe nga ato të cekura tek katalogu Chigo në këtë folder, sepse ky brend ka klasë të energjisë A me dy plusa në ngrohje dhe jo me tre si është kërkuar në dosje dhe siç OE Infiniit e ka prezentuar tek katalogu Chigo.

? Në këtë folder janë dorëzuar disa certifikata të konformitetit, por askund në certifikata nuk shkruan brendi ose modeli për të cilin lëshohet certifikata e konformitetit, por duke ditur se OE Infiniit ka ofertuar me modele të ndryshme siç e cekëm më lart, të cilat kanë specifika të ndryshme, atëherë s’ka se si të merret si dokument i përgjegjshëm nga AK një gjë e tillë.

Pretendimi 3 – Mungesa e dëshmive për përvojë të ngjashme

OE “Infini” nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes të Mundësitë teknike dhe profesionale – pika 1:

Operatorët ekonomikë duhet të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e shkuara që paraprijnë datën e publikimit të njoftimit për këtë kontratë.

OE “Infini” ka paraqitur vetëm një listë të kontratave, pa dokumente mbështetëse si referenca të lëshuara nga autoritetet kontraktuese përkatëse.

AK, edhe në këtë pretendim, arsyetohet se OE ka sjellë dëshmi të referencave, madje përshkruan edhe një të tillë. Mirëpo, nëse vërtet ekzistojnë ato dëshmi, atëherë AK nuk ka ofruar qasje në dokumentacionin e shkëmbyer përmes letrave standarde me OE-në gjatë vlerësimit të tenderit, sepse në FDT dhe në ofertë nuk dëshmohet ekzistenca e asaj dëshmie, po ashtu as neve si pale që kemi kërkuar qasje nuk na është dhënë kjo dëshmi.

Pretendimi 4 – Praktika e OE “AWA” për mos kthim të përgjigjeve, kalimi Irendit për shpërblim tek Infini

Është bërë praktikë në disa raste në prokurimin elektronik që OE “AWA” ka çmimin më të ulët, dhe pas kërkesës për sqarime përmes letrave standard nga AK, OE në fjalë nuk kthen përgjigje. Në këtë mënyrë, AK kalon për shpërblim tek oferta tjetër – në të katër rastet tek “Infini”.

OE AWA nuk ka kthyer përgjigje për dokumentet shitesë edhe në këtë procedurë, ndonëse kërkesa e AK ka qenë që përmes letrës standard të sillen referencat. Përderisa janë dokumente ekzistuese, të dëshmuara me referenca apo afër ndonjë dëshmie se projekti nga lista është përfunduar – pse një OE mos të kthejë përgjigje?! Pse kjo të bëhet praktikë për 1 muaj në 4 raste?

Praktikat e deritanishme e kanë dënuar një fenomen të tillë dhe assesi nuk duhet të lejohej vazhdimi i traditave të tilla të krijuara nga OE të papërgjegjshëm. AK është dashur shumë mirë ta dijë si të veprojë, sepse të njëjtin shqetësim e kemi shprehur edhe në Kërkesën për rishqyrtim. Përderisa një OE jep deklaratë nën betim për përmbushjen e kriterëve, ai zotohet se i ka në dispozicion të gjitha dokumentet dhe se ato janë reale. Ose, në të kundërtën, nëse nuk i paraqet referencat nga lista, atëherë ka dhënë deklaratë të rreme nën betim.

Kjo është një praktikë e përsëritur dhe ngre dyshime shumë të bazuara mbi seriozitetin dhe qëllimin e tyre në këtë proces, me qëllim të përfitimit përmes çmimit më të lartë. Sidoqoftë, ne po e shpalojmë këtë shqetësim, përderisa kjo është një dukuri e përsëritur dhe ka bazë për dyshim. Shpresojmë që ju si organ kompetent për ndalimin e veprimeve të

tilla eventuale të jepni gjykimin tuaj të drejtë me qëllim që të mos lejohet prishja e tregut dhe manipulimi me çmime. **(Prova 2- kate rastet kur OE AWA nuk kthen pergjigje ndersa shperblimi kalon tek Infiniit)**

Kërkojmë:

- Aprovimin e pretendimeve tona dhe të Ankesës në përgjithësi;
- Zbardhjen e të gjitha dyshimeve të ngritura dhe trajtimin e tyre me profesionalizëm të plotë;
- Kthimin e lëndës në rivlerësim;
- Dhënien e direktivave për Autoritetin Kontraktues që vlerësimi i ofertave të bëhet në përputhje me kriteret e dosjes së tenderit dhe me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), dhe rrjedhimisht, shpërblimin me kontratë të ofertës së OE AS Tech.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te papercaktuara

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*